REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA PËR TË DHËNAT E HAPURA DHE KONSULTIMIN PUBLIK

Nr. 3318/1 prot. Tiranë, më 20.11.2026

REKOMANDIM

Nr.76, datë 20.11.2026

MBI ZBATIMIN E LIGJIT NR. 33/2022 "PËR TË DHËNAT E HAPURA DHE RIPËRDORIMIN E INFORMACIONIT TË SEKTORIT PUBLIK" NGA INSTITUTI I STATISTIKAVE

Në mbështetje të nenit 19 të ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik",

KONSTATOHET SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") është institucioni përgjegjës për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e së drejtës për ripërdorim të dokumenteve të organeve të sektorit publik, referuar nenit 19, pika 1, të ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik" (në vijim "ligji nr. 33/2022").

Në zbatim të "*Planit të monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 33, datë 31.03.2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik" nga organet e sektorit publik, për vitin 2026*", publikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit, dhe Urdhrit nr. 53, datë 11.03.2026 "*Për miratimin e "Manualit të monitorimit online dhe metodologjia e vlerësimit të publikimit të të dhënave të hapura nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike"*", u krye procesi i monitorimit, me objekt:

- *Monitorimi online i faqes zyrtare të Institutit të Statistikave, në linkun https://www.instat.gov.al/, lidhur me përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e monitorimit *online* nga struktura përgjegjëse dhe provat e administruara gjatë këtij procesi monitorimi, vëren se:

- Ligji nr. 33/2022, në nenin 3 "Fusha e zbatimit", shkronja "a", përcakton se: *"Ky ligj zbatohet për ripërdorimin e: a) dokumenteve ekzistuese që mbahen nga organet e sektorit publik".*

Në pikën 9 të nenit 6 të ligjit nr. 33/2022 përcaktohet se: *""Organet e sektorit publik" përfshin çdo organ të pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative; çdo organ të enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative; çdo organ të pushtetit vendor që kryen funksione administrative; çdo organ të Forcave të Armatosura, për aq kohë sa kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdolloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike".*

Për sa më sipër, në kuptim të ligjit nr. 33/2022, Instituti i Statistikave konsiderohet organ i sektorit publik dhe duhet të zbatojë detyrimet ligjore sipas dispozitave të mëposhtme të këtij ligji:

- Sipas nenit 6, pika 15: *""Të dhëna të hapura" është format i pavarur nga platforma, i vënë në dispozicion të publikut pa asnjë kufizim që pengon ripërdorimin e dokumenteve".*

- Sipas nenit 7, pika 3: *"Organi i sektorit publik përcakton listën e dokumenteve ekzistuese që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura, të cilën e bën publike".*

- Sipas nenit 9, pika 4: *"Organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike, për aq sa është e mundur teknikisht, i bëjnë të disponueshme të dhënat për ripërdorim menjëherë pas mbledhjes, përmes ndërfaqeve të përshtatshme API, në formë dinamike ose kur është e përshtatshme, si një shkarkim i vetëm voluminoz (bulk download)".*

- Sipas nenit 10, pikat 1, 2 dhe 5:

  "1. Ripërdorimi i dokumenteve, si rregull, ofrohet pa pagesë.

  2. Ripërdorimi i dokumenteve mund të bëhet kundrejt një tarife për të mbuluar kostot shtesë për arsye të riprodhimit, ofrimit e shpërndarjes së dokumenteve, për anonimizimin e të dhënave personale, si dhe për masat e marra për të mbrojtur informacionin sekret tregtar.

  5. Për çdo rast ku aplikohet tarifa, metodologjia, masa dhe përdorimi i tarifës duhet të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Organi i sektorit publik që aplikon tarifa për të drejtën e ripërdorimit e bën atë publike në faqen e vet të internetit, si dhe në portalin unik qeveritar të të dhënave të hapura".

- Sipas nenit 11, pika 2: *"Ripërdorimi i dokumenteve është i hapur ose kundrejt aplikimit të licencës standarde. Në rastin e aplikimit të licencës standarde, licenca ofrohet në formatin elektronik sipas modelit të miratuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".*

- Sipas nenit 12, pika 1: *"Me qëllim lehtësimin e kërkimit të të dhënave të hapura të ofruara nga organet e sektorit publik, krijohet/funksionon portali i të dhënave të hapura qeveritare. Ky portal krijohet dhe administrohet nga AKSHI".*

Në interpretim të këtij neni, organet e sektorit publik duhet të mundësojnë ndërveprimin me portalin e të dhënave të hapura qeveritare, opendata.gov.al.

- Sipas nenit 16, pika 1: *"Në grupin e të dhënave me vlerë të madhe përfshihen të dhëna në fushat:*

  b) mjedisore dhe të vëzhgimit të tokës;
  ……."

- Sipas nenit 17, pikat 1 dhe 2:

  "1. Për çdo kategori të të dhënave me vlerë të madhe për ekonominë dhe shoqërinë nga organi/et publike përgjegjëse, në koordinim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përcaktohen grupet specifike të këtyre të dhënave.

  2. Grupet specifike të të dhënave me vlerë të madhe duhet të jenë:
  a) të disponueshme pa pagesë;
  b) të lexueshme nga kompjuteri;
  c) të ofruara përmes API-ve; dhe
  ç) kur është me rëndësi, të ofruara si një shkarkim i vetëm".

- Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 2, datë 06.02.2025 "Për miratimin e licencës standarde të ripërdorimit të informacionit të sektorit publik", përcakton këto detyrime kryesore për organet e sektorit publik:

  - ✓ Sipas Kreut II, Fusha e zbatimit, shkronja "a": *"Ky udhëzim zbatohet nga organet e sektorit publik, për ripërdorimin e dokumenteve ekzistuese që mbahen prej tyre, në kuadër të detyrës publike".*
  - ✓ Sipas Kreut III, pika 2: *"Licenca do të jetë në format elektronik dhe do të shoqërojë informacionin që do të publikohet nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike në faqet e tyre zyrtare dhe në portalin opendata.gov.al".*
  - ✓ Sipas pikës 5: *"Organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike do të bashkëpunojnë me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit lidhur me implementimin e licencave në formatin elektronik, për dokumentet në formatin e të dhënave të hapura, në faqet e tyre zyrtare dhe në portalin opendata.gov.al, ripërdorimi i të cilave kërkon aplikimin e licencës standarde".*
  - ✓ Sipas Kreut V, pika 2: *"Ky udhëzim zbatohet nga organet e sektorit publik, sipërmarrjet publike në Republikën e Shqipërisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit".*

Në përmbushje të këtyre përcaktimeve ligjore vlerësohet se Instituti i Statistikave luan një rol thelbësor në krijimin dhe publikimin e të dhënave në fushën e mjedisit, e cila është një kategori të rëndësishme e të dhënave me vlerë të madhe, referuar neneve 16 dhe 17 të ligjit nr. 33/2022.

Instituti i Statistikave (në vijim "INSTAT") është institucioni qendror i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, përgjegjës për mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe

publikimin e të dhënave statistikore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statistikat zyrtare.

INSTAT e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare", ligjit nr. 30/2022 "Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 – 2026", si dhe planeve vjetore për zbatimin e këtij programi.

Programi i Statistikave Zyrtare përcakton drejtimet e zhvillimit të statistikave zyrtare, aktivitetet statistikore, burimet e informacionit dhe institucionet përgjegjëse për prodhimin e tyre. INSTAT është përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e këtij programi, në përputhje me kërkesat e cilësisë dhe standardet statistikore kombëtare dhe europiane.

Veprimtaria e INSTAT-it përfshin, ndër të tjera, prodhimin dhe publikimin e statistikave në fushën e mjedisit, bujqësisë dhe llogarive ekonomike të mjedisit. Në këto fusha publikohen të dhëna mbi mbetjet e ngurta urbane, përdorimin e tokës bujqësore, sipërfaqet e mbjella dhe prodhuese, prodhimin bujqësor, si dhe tregues që lidhen me flukset e materialeve mjedisore dhe taksat mjedisore.

INSTAT ka detyrimin ligjor për publikimin e dokumenteve dhe të dhënave publike që mban dhe prodhon referuar akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e këtij organi të sektorit publik, në format të hapur (*open data*), të lexueshëm nga kompjuteri, të aksesueshëm dhe të ripërdorshëm, së bashku me *metadata*-n, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 33/2022.

Në kuadër të zbatimit të detyrimeve ligjore të mësipërme dhe detyrimeve të ligjit nr.33/2022, Zyra e Komisionerit ka kryer monitorimin *online* të faqes zyrtare të INSTAT, konkretisht rubrikave dhe përmbajtjes së tyre, bazuar në dimensionet e vlerësimit të këtij procesi të monitorimit *online*, referuar "*Manualit të monitorimit online dhe metodologjia e vlerësimit të publikimit të të dhënave të hapura nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike*".

Monitorimi synon të evidentojë dokumentet, tabelat statistikore dhe materialet e publikuara nga INSTAT, të cilat lidhen me fushën e mjedisit dhe përdorimit të tokës, duke vlerësuar mënyrën e organizimit të informacionit, formatet e publikimit, përditësimin e të dhënave dhe kushtet për ripërdorimin e tyre.

Në këtë kuadër, vlerësimi është përqendruar tek informacioni që lidhet drejtpërdrejt me objektin e monitorimit dhe jo te të gjitha fushat statistikore që mbulon INSTAT.

Nga monitorimi i faqes zyrtare të INSTAT-it, në linkun https://www.instat.gov.al/, për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 33/2022, bazuar në objektin e këtij monitorimi për "të dhënat mjedisore e vëzhgimit të tokës", rezulton se:

1. INSTAT, në cilësinë e organit të sektorit publik, në faqen e tij, në rubrikën "Temat", ka të listuar të gjithë sektorët në të cilët shtrin veprimtarinë e tij për prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare. Kjo mund të konsiderohet edhe si një listë e dokumenteve që mban e prodhon dhe që mund të ofrohen në format të hapur, sikurse kërkohet nga neni 7, pika 3 e ligjit nr. 33/2022.

2. Nga verifikimi i përmbajtjes së këtyre rubrikave konstatohet se ato përmbajnë informacione/lista/statistika lidhur me fusha të caktuara, për të cilat INSTAT duhet të mbledhë/përpunojë/krijojë/prodhojë dhe publikojë të dhëna referuar detyrimeve ligjore sipas fushës së përgjegjësisë. Nëse klikojmë mbi emërtesën e çdo dokumenti të listuar në këto rubrika konstatohet se ato ofrojnë informacion të publikuar të fragmentizuar e të papërditësuar.

3. Për sa i përket formatit të dokumenteve, rezulton se ato jo gjithmonë janë në formate të hapura, të lexueshme nga kompjuteri, me qëllim ripërdorimin, referuar detyrimeve ligjore që duhet të përmbushë INSTAT.

   Lidhur me konstatimet e mësipërme, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 33/2022, më poshtë paraqitet situata konkrete pas verifikimit të përmbajtjes së rubrikave të publikuara në faqen zyrtare të INSTAT-it.

   Në kuadër të këtij monitorimi, vlerësimi i INSTAT-it është përqendruar vetëm në pjesën e veprimtarisë që lidhet me prodhimin dhe publikimin e të dhënave mjedisore dhe të dhënave mbi bujqësinë të cilat lidhen apo kanë ndikim në vëzhgimin e tokës. Nga shqyrtimi i rubrikave tematike të INSTAT-it rezulton se institucioni publikon të dhëna statistikore për mjedisin dhe bujqësinë, përfshirë publikime periodike, tabela statistikore, databaza dhe raporte të cilësisë. Vlerësimi përfshin gjithashtu shqyrtimin e formateve të publikimit, mundësive të shkarkimit dhe ripërdorimit, si dhe identifikimin e informacionit që duhet të publikohet në përputhje me detyrimet ligjore të zbatueshme. Të dhënat e identifikuara paraqiten në vijim, në mënyrë joshteruese.

   Në menunë kryesore të faqes gjenden rubrikat e listuara si më poshtë, që përmbajnë informacione lidhur me veprimtarinë e INSTAT-it, të cilat duhet të publikohen në përputhje me detyrimet e ligjit nr. 33/2022:

- Në menunë kryesore “Temat”, në rubrikën “Mjedisi dhe Energjia”/Mjedisi/Shifrat, gjejmë publikime statistikore për:

  Ndotja bakteriologjike e ujit të detit në plazhe
  Mbetje urbane të menaxhuara
  Ndotja nga zhurmat në zonat e banuara
  Përmbajtja e disa ndotësve atmosferikë në qytetet kryesore
  Cilësia e Ujit në lumenjtë e Shqipërisë

  Të dhënat janë publikuar në formatin xlsx.

  Në nënrubrikën “Publikimet” gjejmë të dhëna të publikuara për “Mbetjet e Ngurta Urbane”, ndër vite, informacion ky i publikuar në formatin pdf.

- Në menunë kryesore “Temat”, në rubrikën “Bujqësia dhe Peshkimi”/Peshkimi/ Shifrat, gjejmë publikime statistikore për:

Zënie peshku sipas kategorive ujore
Flota Detare sipas llojit të anijes
Flota Detare sipas porteve
Zëniet sipas specieve në kategorinë ujrat e brendshme
Zëniet sipas specieve në kategoritë detare, bregdetare dhe laguna

Të dhënat janë publikuar në formatin xlsx.

Në nënrubrikën "Publikimet" gjejmë të dhëna të publikuara për "Statistikat e Peshkimit", ndër vite, informacion ky i publikuar në formatin pdf.

Gjithashtu, në nënmenunë "Pyjet"/Shifra, gjejmë të publikuara të dhëna statistikore për:

Fondi kullosur sipas pronësisë
Fondi pyjor sipas pronësisë
Rrjeti i zonave të mbrojtura
Investime të realizuara në pyje (mijë lekë)
Të dhëna për bilancin kadastral të fondit pyjor e kullosor të Shqipërisë

Të dhënat janë publikuar në formatin xlsx.

Në nënrubrikën "Publikimet" gjejmë të dhëna të publikuara për "Statistikat e Pyjeve", ndër vite, informacion ky i publikuar në formatin pdf.

Rubrika "Censusi i Bujqësisë", linku https://www.instat.gov.al/sq/temat/censet/censusi-i-bujqesise/?utm_source=chatgpt.com#tab2, përmban tabela statistikore të detajuara mbi strukturën e njësive ekonomike bujqësore dhe përdorimin e tokës.

Këto tabela janë të rëndësishme për objektin e monitorimit, pasi ofrojnë të dhëna për sipërfaqen bujqësore të përdorur dhe ndarjen e saj sipas kategorive dhe qarqeve.

Të dhënat janë publikuar në formatet xls dhe xlsx.

Ekzistenca e tabelave *online* dhe e databazave përbën një element të rëndësishëm të aksesueshmërisë së statistikave. Megjithatë, për të vlerësuar plotësisht përmbushjen e kërkesave për të dhëna të hapura, duhet që të dhënat të mund të shkarkohen në formate të strukturuara dhe të përpunueshme nga kompjuteri, si dhe të shoqërohen me *metadata* dhe kushte të qarta ripërdorimi.

Publikimi i një dokumenti në formatin PDF nuk nënkupton automatikisht se të dhënat janë të ripërdorshme në mënyrë të automatizuar.

- Në menunë kryesore të faqes zyrtare të INSTAT-it, në rubrikën "Rreth nesh", në menunë anësore "Aktivitetet" dhe në nëmenunë "Promovimi i aktiviteteve statistikore", gjendet i publikuar informacioni mbi platformat Geodata Hub dhe WebGIS, në kuadër të prezantimit të aktiviteteve të institucionit. Geodata Hub është platforma *online* e të Dhënave Gjeohapësinore të Institutit të Statistikave, që ofron akses në informacionin statistikor dhe gjeohapësinor të INSTAT-it.

  Ai është krijuar për të përmbushur nevojat e qytetarëve, bizneseve, botës akademike, qeverisë dhe të gjithë aktorëve të interesuar për këto të dhëna, dhe aksesohet në adresën https://instat-data-hub-instat.hub.arcgis.com/pages/regional-statistics.

- Në menunë "Statistikat Rajonale", në fund të faqes, në seksionin "Shkoni te katalogu i të dhënave statistikore rajonale", gjejmë 2 rubrika:
  - ✓ "Bujqësia dhe Peshkimi", ku gjejmë të publikuara të dhëna sipas viteve 2023, 2024 dhe 2025, gjithsej 31 *datasets*, në format të hapur dhe kundrejt licencës CC BY-NC-ND 4.0, në linkun https://instat-data-hub instat.hub.arcgis.com/search?groupIds=d319e07a922c452f81ca3f8ef9ee6899.
  - ✓ "Mjedisi dhe Energjia" ku gjejmë të publikuar të dhëna për vitet 2023 dhe 2024 për "mbetjet e menaxhuara", gjithsej 2 *datasets*, kundrejt licencës CC BY-NC-ND 4.0, në linkun https://instat-data-hub-instat.hub.arcgis.com/search?groupIds=16cea3268e7d406b913b1db4ff61c23d.

  Këto të dhëna janë të publikuara si të dhëna të hapura, përditësuar në hartë, shoqëruar me *metadata*.

- Platforma Web GIS e Institutit të Statistikave, referuar informacionit në faqe, është një sistem *online* që ofron akses në sistemin e informacionit gjeografik (GIS) përmes aplikacioneve të bazuara në *web*. Kjo platformë mundëson analizimin, shkarkimin dhe ndarjen e të dhënave gjeohapësinore në internet. Gjithashtu, kjo platformë mundëson hartëzimin interaktiv, analizat hapësinore, duke e bërë më të lehtë për përdoruesit nga fusha të ndryshme qasjen dhe përdorimin e të dhënave GIS dhe aksesohet në adresën https://instatgis.gov.al/.

  Në lidhje me informacionin e publikuar në këtë platformë, paraqitet e njëjta situatë me atë të publikuar në platformën Geodata Hub, lidhur me objektin e monitorimit. Këto të dhëna janë të publikuara në Hartë, shoqëruar me *metadata*.

4. Në fund të faqes zyrtare nuk gjendet e publikuar logoja e licencës që përcakton kushtet e aksesit dhe ripërdorimit të të dhënave, në përputhje me legjislacionin për statistikat zyrtare, ligjin nr. 33/2022 dhe në përmbushje të detyrimeve të "Udhëzimit të përbashkët nr. 2, datë 06.02.2025 "Për miratimin e licencës standarde të ripërdorimit të informacionit të sektorit publik"".

   Vendosja e licencës konstatohet vetëm në të dhënat e publikuara në platformën Geodata Hub, ku për të dhënat e publikuara është përdorur licenca CC BY-NC-ND 4.0.

   Referuar nenit 11, pika 1, të ligjit nr. 33/2022: *"Ripërdorimi i dokumenteve, si rregull, është i hapur dhe vendosja e kushteve bëhet në raste të justifikuara për interesin publik. Kushtet për ripërdorimin e dokumenteve duhet të jenë objektive, proporcionale dhe jodiskriminuese"*. Referuar këtyre parashikimeve, INSTAT duhet të konsiderojë vendosjen e licencave të përshtatshme për kushtet e aksesit dhe ripërdorimit të të dhënave, në përputhje me legjislacionin për statistikat zyrtare, ligjin nr. 33/2022 dhe Udhëzimin e përbashkët nr. 2, datë 06.02.2025.

5. Referuar nenit 10 të ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", ripërdorimi i dokumenteve ofrohet, si rregull, pa pagesë, ndërsa aplikimi i tarifave lejohet në rastet dhe sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj. Gjithashtu, edhe pika 2/a e nenit 17 parashikon se grupet specifike të të

dhënave me vlerë të madhe, ku bëjnë pjesë edhe të dhënat mjedisore të vëzhgimit të tokës si dhe të dhënat statistikore (referuar nenit 16), duhet të jenë "të disponueshme pa pagesë".

Ndërkohë, nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare" parashikojnë mundësinë e tarifimit të shërbimeve statistikore të caktuara, mbi bazën e kostove përkatëse dhe sipas akteve rregullatore në fuqi. Për rrjedhojë, vlerësimi i këtij kriteri, pra aplikimi i tarifave, duhet të marrë në konsideratë dallimin ndërmjet ripërdorimit të statistikave ekzistuese të publikuara dhe shërbimeve statistikore të posaçme që ofrohen kundrejt tarifës.

6. Nga verifikimi në portalin opendata.gov.al nuk konstatohen të dhëna apo dokumente të publikuara nga INSTAT lidhur me veprimtarinë e saj në fushën mjedisore të vëzhgimit të tokës.

   Referuar këtij procesi monitorimi dhe vlerësimi, bazuar në dokumentin "*Metodologjia e vlerësimit të publikimit të të dhënave të hapura nga Organet e Sektorit Publik dhe Sipërmarrjet Publike*", rezulton një nivel "Përputhshmërie e pjesshme" e këtij organi të sektorit publik, në zbatimin e ligjit nr. 33/2022.

Ligji nr. 33/2022 përcakton se të dhënat e hapura nuk kanë vetëm funksion informues, por synojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ripërdorimin e informacionit të sektorit publik për qëllime ekonomike, sociale, kërkimore, inovative dhe zhvillimore.

Në këtë kuptim, publikimi i të dhënave në formate të hapura dhe të lexueshme nga kompjuteri synon krijimin e mundësisë që këto të dhëna të analizohen, përpunohen, kombinohen dhe ripërdoren nga aktorë të ndryshëm publikë dhe jopublikë, në funksion të zhvillimit të politikave të bazuara në evidencë, rritjes së transparencës dhe nxitjes së inovacionit digjital.

Në mënyrë të veçantë, të dhënat mjedisore përbëjnë kategori të të dhënave me vlerë të madhe (*high-value datasets*), sipas nenit 16 të ligjit nr. 33/2022 dhe standardeve të Direktivës (BE) 2019/1024, për shkak të ndikimit të tyre të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e mjedisit, shëndetin publik, kërkimin shkencor, monitorimin e ndotjes, menaxhimin e burimeve natyrore dhe zhvillimin e shërbimeve digjitale me interes publik.

Për rrjedhojë, mospublikimi i tyre në formate të hapura, të strukturuara dhe të ripërdorshme, në përputhje me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 33/2022, kufizon ndjeshëm mundësinë e përdorimit efektiv të informacionit publik nga qytetarët, komuniteti akademik, organizatat e shoqërisë civile, media dhe sektori privat.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 7, 9, 10, 11, 12, 17 dhe 19 të ligjit nr. 33/2022, Komisioneri,

REKOMANDON:

1. Organi i sektorit publik "Instituti i Statistikave, në rubrikat "Mjedisi dhe Bujqësia" dhe "Bujqësia dhe Peshkimi", të publikojë një listë të identifikueshme dhe të përditësuar të produkteve statistikore që lidhen me këto tema, të cilat mund të ofrohen

në formatin e të dhënave të hapura, në zbatim të nenit 7, pika 3, të ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik".

2. Dokumentet në këtë listë, për aq sa është e mundur, të publikohen në format të hapur/*open data*, të lexueshëm nga kompjuteri, të aksesueshëm dhe të ripërdorshëm, të shoqëruara me metadata, në zbatim të nenit 9 dhe kushteve të nenit 17 të ligjit nr.33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik".

3. Të bëhen të qarta kushtet e aksesit dhe ripërdorimit të të dhënave, në përputhje me legjislacionin për statistikat zyrtare dhe ligjin nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", duke vendosur licencën përkatëse, në zbatim të Udhëzimit të përbashkët nr. 2, datë 06.02.2025 "Për miratimin e licencës standarde të ripërdorimit të informacionit të sektorit publik".

4. Dokumentet/të dhënat të publikohen edhe në portalin opendata.gov.al me *metadata* dhe përditësim periodik, në zbatim të nenit 12 të ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik".

5. Në zbatim të nenit 18 dhe pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", detyrimet e përcaktuara në këtë Rekomandim të plotësohen brenda 90 ditëve nga data e marrjes dijeni.

Ky Rekomandim u shpall sot, më datë 20.11.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi